

31 Maj, Dita Botërore pa Duhan

Dita Botërore pa Duhan është një ditë që i kushtohet luftës kundër duhanit. Mbahet që prej 1987 çdo 31 maj. Çdo herë ka një temë të veçantë.

31 Maji është Dita botërore pa duhan dhe është shpallur nga vendet anëtarë të OBSH-se. Në vitin 1987, vendet anëtare të OBSH, duke përcaktuar këtë ditë, u përpoqën të sensibilizojnë opinionin mbi dëmet dhe rreziqet e duhanit dhe të inkurajojnë reduktimin e prodhimit dhe konsumit të duhanit. Për këtë arsye, çdo vit propozohet një slogan mbi luftën kundër duhanit.

Me rastin e Ditës botërore pa duhan, Ministria e Shëndetësisë çdo vit, duke filluar që nga viti 1998, ka organizuar aktivitete informuese, edukuese në mbështetje të temës së ditës botërore të dhënë nga OBSH gjatë çdo muaji Maj.

Në prag të Ditës botërore pa duhan, zakonisht publikohen raporte dhe statistika të ndryshme mbi dëmet e shkaktuara nga konsumi i duhanit.

Mesazhi i Ditës Botërore pa duhan për vitin 2012, ishte zgjedhur:

"Kujdes! Ndaloni ndërhyrjet e kompanive shumëkombëshe të prodhimit të duhanit."

Mesazhi i ditës botërore pa duhan për vitin 2013 është:

"Te ndalojmë promovimin dhe sponsorizimin nga industria e duhanit të çfarëdolloj aktiviteti".

Epidemia e duhanpirjes

Duhani është një nga sfidat më të mëdha të shëndetit publik të cilat Shqipëria po përballet sot. Vendi ynë renditet në vendet me përqindje të larta të duhanpirjes, 60% meshkuj, 18% në femra me një tendencë në rritje të femrat, dhe ulje të numrit të duhanpirësve meshkuj.

Pirja e duhanit renditet si faktor i madh riskant për sëmundjet malinje, sëmundjet kardiovaskulare, sëmundje të aparatit të frymëmarrjes dhe probleme të tjera shëndetësore. Duhani është shkaku kryesor i shume vdekjeve që mund të shmanget. Është i vetmi produkt që konsumohet legalisht që vret një të tretën deri në një të dytën e atyre që e përdorin.

Në mbarë botën, duhani shkakton 5.4 milion vdekje në vit, një shifër kjo që pritet të rritet në 8 milion në 2030, nëse vazhdon kjo shkallë e përdorimit. Mbi 70% e vdekjeve ndodhin në vendet e varfra dhe në zhvillim. Në Shqipëri më shumë se 3.300 njerëz vdesin çdo vit nga pasojat që shkakton pirja e duhanit dhe në 2030 ky numër do të rritet në rreth 7.500 njerëz.

Duhani i vret edhe femrat

Rekord i trishtueshëm: femrat janë duke u barazuar me kalimin e kohës me duhanpirjen e meshkujve. Numri i vdekjeve të parakohshme për shkak të duhanpirjes tek femrat (kancer i mushkërive, sëmundje vaskulare, etj) është në rritje të vazhdueshme. Duhani vret! Femrat duhanpirëse janë po aq të rrezikuara nga sëmundjet e lidhura me duhanin, sa edhe meshkujt duhanpirës.

Duhani dhe Varfëria një rreth vicioz

Kontributi i Duhanit ne vdekshmërinë e parakohshme dhe ne sëmundshmeri, është dokumentuar. Megjithatë i është kushtuar pak vëmendje lidhjes se duhanit me varfërinë.

Duhani tenton te konsumohet nga ata qe janë te varfër, si rrjedhoje ai shkakton varfëri përmes uljes te se ardhurave, uljes se produktivitetit, semundeshmerise dhe vdekjes.

Se bashku duhani dhe varfëria krijojnë një rreth vicioz qe shpesh është e vështirë ti shpëtosh.

Ne disa mënyra duhani rrit varfërinë ne nivelin : Individual, familjar, Kombëtar. Ne nivelin Individual dhe familjar paratë e shpenzuara per duhanin kane një kosto oportune shume te larte. Per te varfrit, paratë e shpenzuara per duhanin janë para qe nuk shpenzohen per nevojat baze, si ushqimi, veshja, edukimi dhe kujdesi shëndetësor. Duhani jep varfëri individuale dhe familjare duke rritur rrezikun per sëmundje, dhe vdekje te parakohshme si: kancer, atak te zemrës, sëmundje respiratorë e tjera, duke rritur koston per kujdes shëndetësor.

Ne nivel kombëtar vendi vuan nga humbje te jashtëzakonshme ekonomike, si rezultat i kostove te larta i kujdesit shëndetësor si dhe humbjes se produktivitetit nga sëmundjet qe shkakton duhanpirja dhe nga vdekjet e parakohshme.

Vendet importuese te duhanit humbin miliona Euro nga shkëmbimi i jashtëm. Vendi ynë ble produkte duhani ne masën 550 milion Euro ne vit, pra blihet një produkt qe shkakton vdekje dhe sëmundje. Kultivimi i duhanit degradon mjedisin.

"Konventa Kornizë për Kontrollin e Duhanit"

Kjo Konvente, është adoptuar unanimisht më 21 Maj 2003 në Asamblenë e 56-të të Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH), dhe përbën instrumentin legal më të rëndësishëm për kontrollin e duhanit në rang botëror e cila hyri në fuqi në vitin 2005.

Në 29 Qershor 2004 vendi ynë firmosi Konventën për Kontrollin e Duhanit. Organizata Botërore e Shëndetit ka dhënë një kontribut shumëvjeçar për arritjen e këtij suksesi.

Aprovimi në parlament i konventës për kontrollin e duhanit në Prill 2006, e obligonte vendin tonë që të aprovonte një ligj për kontrollin e duhanit, i cili të reflektonte konventën.

Ratifikimi i Konventës për Kontrollin e Duhanit, nënkupton ndërmarrjen e masave legislative, ekzekutive, administrative dhe/ose masave të tjera brenda afateve të përcaktuara në Konventë. Në këtë kuadër u hartua ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” i cili u miratua në Kuvendin e Shqipërisë në dt 6 Nëntor 2006, pas konsultimesh intensive mes ekspertëve të dikastereve të ndryshme dhe me asistencën teknike te OBSH-se. Ligji reflekton dispozitat e Konventës për Kontrollin e Duhanit. Ky ligj hyri në fuqi më 26 Maj 2007.

Një nga parimet e Konventës është:

Çdo person duhet të informohet për pasojat shëndetësore, natyrën droguese dhe kërcënimin vdekjeprurës të shfaqur nga konsumimi i duhanit dhe ekspozimi ndaj tymit të tij dhe masa të tjera efektive legislative, ekzekutive dhe administrative në nivelin e duhur qeveritar duhen të merren për të mbrojtur të gjithë personat nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit.

Pse te kemi mjedise 100% pa duhan?

- 1- Duhanpirja pasive vret dhe shkakton shume sëmundje.
- 2- Mjediset 100% pa duhan mbrojnë plotësisht punonjësit dhe publikun nga efektet e dëmshme te duhanpirjes pasive.
- 3- Çdo njeri ka te drejte te thithi ajër te pastër, pa tym duhani.
- 4- Shumica e njerëzve ne Shqipëri janë jo-duhanpirës dhe kane te drejtën te mos ekspozohen nga tymi i duhanit te njerëzve te tjerë.(vetëm 39 % janë duhanpirës)
- 5- Ndalimi i duhanpirjes mbështetet gjerësisht nga duhanpirësit dhe jo-duhanpirësit.
- 6- Mjedisi 100% pa duhan ndihmon ne parandalimin e duhanpirjes, sidomos tek te rinjtë.
- 7- Mjedisi 100% pa duhan u jep një shtyese te rëndësishme shume punonjësve qe duan ta lënë duhanin
- 8- Mjediset 100% pa duhan janë te mira per biznesin, duke qene se familjet me fëmijë, qofshin duhanpirës ose jo, preferojnë te shkojnë ne vende publike pa duhan.
- 9- Mjediset 100% pa duhan kushtojnë me pak dhe funksionojnë me se miri!